

Tiranë, më 19.10.2018

**PUBLIKIM I VENDIMIT PER NDRYSHIMIN E KAPITALIT**

Në përputhje me nenin 24, shkronja "e" të ligjit nr.9662, dt.18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimin e Bankës së Shqipërisë për zvogëlimin e kapitalit të BANKA e TIRANËS Sh.A.

Në përputhje me nenin 182 të ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", BANKA e TIRANËS Sh.A bazuar në vendimin e Mbledhjes së Jashtëzakonshme të Asamblesë së Aksionerëve mbajtur më 17.08.2018, njofton sa vijon:

**1. Qëllimi i zvogëlimit të kapitalit aksionar**

Referuar pasqyrave financiare datë 30.06.2018, Raporti i Mjaftueshërisë së Kapitalit (RMK) i BANKA e TIRANËS Sh.A është 26.04%, pas zvogëlimit të kapitalit RMK do të jetë 17.59% vlerë kjo mbi nivelin rregullator prej 15% aplikuar aktualisht për BANKA e TIRANËS Sh.A.

Me qëllim ruajtjen e një kapitali të shëndetshëm, BANKA e TIRANËS Sh.A ka vendosur t'i kthejë aksionerëve kapitalin e tepërt duke e zvogëluar atë me vlerën prej EUR 28.635.254,53 (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër Euro dhe pesëdhjetë e tre Euro Cent).

**2. Përshkrimi i zvogëlimit të kapitalit aksionar****(1) Shuma e zvogëlimit të kapitalit**

Kapitali aksionar prej EUR 108.547.074 (njëqind e tetë milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër Euro) do të zvogëlohet me shumën EUR 28.635.254,53 (njëzetë e tetë milion e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e katër Euro dhe pesëdhjetë e tre Euro Cent).

**(2) Forma e zvogëlimit të kapitalit**

Zvogëlimi i vlerës nominale të aksioneve TIRANA BANK nga EUR 216,24 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë Euro dhe njëzetë e katër Euro Cent) në EUR 159,19 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro dhe nëntëmbëdhjetë Euro Cent) secili.

**(3) Struktura e kapitalit pas zvogëlimit**

Kapitali aksionar pas zvogëlimit do të mbulohet si vijon:



Aksionerët	Vlera Nominale (EUR)	Nr. aksioneve	Pjesëmarrja (EUR)	Pjesëmarrja (%)
PIRAEUS BANK S.A	159,19	496.098	78.976.231,52	98,83
TZIVELIS IOANIS	159,19	5.877	935.587,95	1,17
<b>TOTALI</b>	<b>159,19</b>	<b>501.975</b>	<b>79.911.819,47</b>	<b>100,00</b>

### 3. Perspektiva

Ky transaksion përfaqëson kthimin e shumave të pa nevojshme që janë investuar gjatë viteve nga aksionarët në kapitalin e BANKA e TIRANËS Sh.A, dhe për këtë shkak Raporti i Mjaftueshërisë së Kapitalit (RMK) vazhdon të jetë brenda limitit rregullator dhe nuk ka asnjë efekt në performancën e BANKA e TIRANËS Sh.A.

### 4. Të drejtat e kreditorëve

Kreditorët ftohen të depozitojnë pretendimet e tyre në bazë të nenit 183 të ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Për BANKA e TIRANËS SH.A

Dritan Mustafa  
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



19/10/2018